



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:299272  
Datë: 20.01.2025  
Numri i dokumentit: 06727071

Pml.nr.495/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Agim Maliqi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Sherif Krasniqi, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të pandehurve: N. R., nga M.V. dhe K. H., nga P., për shkak të veprës penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, nga neni 422, paragrafët 1 dhe 2, nën-paragrafët 2.1. dhe 2.2. lidhur me nenin 31 të Kodit të Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, KMLP.I.nr.23/24, datë 06.08.2024, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special, APS.nr.54/2023, datë 25.04.2024, në seancën e kolegjit, të mbajtur më 17.01.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, APS.nr.54/2023, datë 25.04.2024.

A r s y e t i m i

1. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PS.nr.74/2019, datë 01.06.2023, të pandehurit: N. R. dhe K. H., janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, nga neni 422, paragrafët 1 dhe 2, nën-paragrafët 2.1. dhe 2.2. lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa për shkak të kryerjes

së kësaj vepre penale, ndaj të pandehurit N. R., është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) vjetëve, kurse ndaj të pandehurit K. H., është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vjetëve. Gjithashtu, ndaj të pandehurve: N. R. dhe K. H., është shqiptuar edhe dënimi plotësues ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik në kohëzgjatje prej tre (3) vjetëve, pas mbajtjes së dënimeve me burgim. Janë detyruar të pandehurit në fjalë që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe atë: për ekspertizën financiare në mënyrë solidare shumë prej dymijë (2.000) euro, për shpenzimet e paushallit gjyqësor, secili veç e veç shumë prej nga pesëqind (500) euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, secili veç e veç shumë prej nga njëqind (100) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në nenin 363, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurit: Sh. Z., E. Gj., Sh. M., L. Th., L. K. dhe A. Z., janë liruar nga akuza për shkak të veprës penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, nga neni 422, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Shpenzimet e procedurës penale do të paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës. E dëmtuara - Avokatura Shtetërore e Kosovës, pranë Ministrisë së Drejtësisë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

## 2. Vendimi i gjykatës së shkallës së dytë

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special, APS.nr.54/2023, datë 25.04.2023 (pika I. e dispozitivit), janë aprovuar ankesat e mbrojtësve të të pandehurve: N. R. dhe K. H., si dhe sipas detyrës zyrtare, të pandehurit në fjalë, duke u bazuar në nenin 363, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të KPP-së, janë liruar nga akuza, për shkak të veprës penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, nga neni 422, paragrafët 1 dhe 2, nën-paragrafët 2.1. dhe 2.2. lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Shpenzimet e procedurës penale do të paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës. E dëmtuara - Avokatura Shtetërore e Kosovës, pranë Ministrisë së Drejtësisë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil. Gjithashtu, me aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës së Apelit të Kosovës (pika II. e dispozitivit), është refuzuar si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, në pjesën që ka të bëjë me lirimin nga akuza, është vërtetuar. Pjesa e ankesës së PSRK-së lidhur me vendimin mbi dënimin për të pandehurit: N. R. dhe K. H., ka mbetur jo lëndore.

## 3. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 432, paragrafi 1 lidhur me nenin 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7. dhe nenin 369, paragrafët 7 dhe 10 të KPP-së; për shkak të shkeljes së ligjit penal, nga neni 432, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. lidhur me nenin 385, paragrafi 1, nën-

paragrafi 1.4. të KPP-së dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor nga neni 432, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3., si dhe nenet 392 dhe 7 të KPP-së, me propozimin që të aprovohet kjo kërkesë, ndërsa të konstatohet se aktgjykimet e lartcekura janë të përfshira me shkeljet e lartcekura, shkelje këto në favor të të pandehurve: N. R. dhe K. H., e që qartazi vendimi gjyqësor i formës së prerë është i papërshtatshëm dhe i bazuar në gabime të rënda, ndërsa për t'u mënjanuar këto shkelje, çështja duhet të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë.

#### 4. Përgjigja në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë

Përgjigje ndaj kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërinë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit N. R., avokati Miodrag Brkljaq, i cili ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të hedhet si e palejuar apo në rastin kur Gjykata Supreme e Kosovës vendos që ta shqyrtojë në merita, e njëjta të refuzohet si e pabazuar, për shkak se pretendimet nga kërkesa nuk qëndrojnë.

#### 5. Konstatimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe pretendimet e paraqitura në përgjigjen në këtë kërkesë, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

#### 6. Pretendimet e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë thekson se gjykata e shkallës së dytë ka vepruar në kundërshtim me nenin 369, paragrafi 7 të KPP-së, pasi që në këtë rast kemi disa prova kundërthënëse, atëherë nëse lexohet aktgjykimi i kësaj gjykate, vërehet që përpos përshkrimit të deklaratave të dëshmitarëve, nuk ka asnjë vlerësim, e aq më pak që nuk ka vlerësim të veçantë të saktësisë së këtyre provave kundërthënëse, që paraqet një standard më të lartë se pikat tjera të aktgjykimit. Dëshmitarja Sh. De., në dëshminë e saj kishte theksua se "...si anëtare e grupit punues për hartimin e programit të veçantë, ka deklaruar se ky program nuk ka pasur ndonjë analizë të veçantë, më tej shton se asnjëherë nuk kishte pasur program të veçantë apo special të miratuar nga ministria. Sekretari i përgjithshëm është këshilltar i ministrit, s'mundet me ndal kërkesën e ministrit për formimin e komisiointit, por mundet me këshillua nëse mendon se nuk është në rregull, si të gjithë ne që jemi këshilltarë e orientojmë ministrin". Në këtë mënyrë, në kërkesë theksohet se përgjegjësia e tij (duke aluduar në të pandehurin K. H.), si sekretar i përgjithshëm, i njejti konsiderohet se është këshilltar i parë i ministrit lidhur me zbatimin e politikave të ministrisë. Prandaj, i njejti është dashur që të këshillonte ministrin, tani të pandehurin N. R., lidhur me hartimin, përkatësisht lidhur me zbatimin e programit të

veçantë që nuk përcaktohet me ligj dhe t'i marrin për bazë edhe rekomandimet që kishte dhënë zyra ligjore lidhur me opinionin që kishin dhënë për ndryshimin dhe plotësimin e programit të rregullt rural për vitin 2018, në mënyrë që të mund të inkorporohej masa për investimet në infrastrukturën rurale. Po ashtu, edhe me një sërë provash tjera që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor pranë gjykatës së shkallës së parë, vërtetojnë përtej dyshimit të bazuar mirë se të pandehurit: N. R. dhe K. H., me veprimet e tyre kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar dhe shpallur fajtor, pasi që të njejtë kanë rënë në kundërshtim të plotë me Ligjin Nr.03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, si dhe Ligjin Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e këtij Ligji. Theksohet se të pandehurit në fjalë kishin për qëllim që të implementonin programin e veçantë për faktin se në të njejtën ditë që ministri kishte marrë vendimin për hartimin e politikave të reja të zhvillimit rural, i pandehuri K. H., më datë 03.04.2018, përkatësisht në të njejtën datë kishte nxjerrë vendimin nr..., për formimin e grupit punues prej njëmbëdhjetë (11) anëtarëve, e që të njejtë anëtarë nga deklaratimet e tyre veç se e kishin pasur planin e gatshëm të dorëzuar nga zyra e ministrit e të paracaktuara edhe kriteret dhe zonat investuese që në një mënyrë apo tjetër në këtë formë u është përgatitur terreni paraprakisht tani kompanive fituese që të jenë fituese të granteve, ashtu që pa asnjë bazë ligjore të njejtën kanë anashkaluar zonat tjera investuese, duke ua mundësuar kompanive fituese që të kenë më të lehtë t'i fitojnë këto grante përmes programit të veçantë e cili program, është në kundërshtim me ligjin dhe duke mos e pasur në konsideratë opinionin ligjor të lëshuar nga Departamenti Ligjor i kësaj Ministrie, cili ua kishte bërë të qartë të pandehurve se janë duke vepruar në kundërshtim të plotë me ligjin.

Pretendohet se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk është përpiluar sipas dispozitës ligjore të nenit 369, paragrafi 10 të KPP-së, pasi që arsyetimi i këtij aktgjykimi është i mangët dhe në të nuk janë paraqitur arsye në lidhje me lirimin nga akuza të të pandehurve: N. R., dhe K. H. Gjykata në fjalë në arsyetimin e aktgjykimit të saj (faqe 16), ndër të tjera kishte ngritur si çështje për diskutim “nëse ky vendim për këtë program të veçantë bujqësor kishte qëllim që t’iu siguronte përfitime të paligjshme kompanive: Konzorciumit “N.” sh.p.k., Konzorciumit “Dh.”, sh.p.k., Konzorciumit “D.. Z. P.”, si dhe Konzorciumit NTP “A. E.” në P., dhe nuk kishte qëllim zhvillimin e infrastrukturës rurale dhe ngritjen e konkurrencshmërisë në zonat rurale më pak të zhvilluara”, kurse pretendohet se ky program ishte në kundërshtim me ligjin dhe kishte qëllim kriminal, ndërsa kjo bazohet në faktin se vetë ministri kishte vendosur mbi kriteret, përkatësisht kishte përcaktuar regjionet për financim dhe shumën e grantit për përfituesit e granteve, e që kjo vërtetohet nga vetë vendimi i ministrit, përkatësisht të pandehurit N. R., i cili më datë 03.04.2018, kishte nxjerrë vendimin për hartimin e politikave të reja për zhvillim të mëtejshëm në infrastrukturën rurale dhe rritjen e konkurrencshmërisë në zonat më pak të zhvilluara, ku edhe në bazë të vendimit kishte përcaktuar si përfitues nga ky program regjionin e Mitrovicës, e krejt kjo, jo rastësisht për faktin se po i njejtë ministër jeton në atë zonë, e që le të nënkuptojmë se vetëm paraprakisht të njejtave kompani fituese ju kishte përshtatur kriteret për fitimin e granteve dhe në një formë apo tjetër, ju kishte hapur rrugë që të njejtat të fitojnë, duke ju minimizuar konkurrencën në minimum, pasi që i gjithë ky fond

ka shkuar në një zonë shumë të vogël e që rrjedhimisht shumë pak kompani i kanë përmbushur kriteret apo pothuajse vetëm kompanitë fituese. Gjithashtu, në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, është ngritur si pyetje se “Cilat janë provat që dëshmojnë dijeninë e të akuzuarve me rastin e hartimit të këtij programi, se në konkursin dhe procedurat e përcaktimit e granteve do të aplikojnë kompanitë: Konzorciumi “N.” sh.p.k., Konzorciumi “Dh.”, sh.p.k., Konzorciumi “D. Z. P.” dhe Konzorciumit NTP “A. E.” në P.”, mirëpo nuk zbërthen se pse veprimet e të pandehurve nuk përbëjnë vepër penale.

Shkelje tjetër e dispozitave të procedurës penale pretendohet se është bërë edhe kur gjykata sipas detyrës zyrtare nuk ka bërë përpjekje për sigurimin e provave të reja sipas detyrës zyrtare, konform neneve 392 dhe 7 të KPP-së, në mënyrë që të dëshmojë lidhjen objektive në mes të hartimit të programit të veçantë të bujqësisë, shkeljeve të dispozitave ligjore dhe përfutimit të kompanive të cilat kanë qenë përfituese të granteve, në njërin anë, me lidhjen subjektive të të pandehurve, që këto veprime i kanë ndërmarrë për të krijuar përfitime të paligjshme për kompanitë e lartcekura.

Gjithashtu, theksohet se gjykata e shkallës së dytë ka dështuar që në mënyrë të qartë të argumentojë që të pandehurit: N. R. dhe K. H., nuk kanë pasur qëllimin, dashjen dhe dijeninë që tani përfituesve të granteve, me veprimet e tyre të kundërligjshme t’ju mundësojnë fitimin e granteve në kundërshtim me ligjin, në asnjë pjesë të aktgjykimit, gjykata e shkallës së dytë nuk e potencon se cili fakt i bënë jo përgjegjës të pandehurit në fjalë, por që është mundur që përmes arsytimit kamufloze dhe të përgjithshme, pa asnjë bazë ligjore të argumentojë faktin se të pandehurit nuk e kanë kryer veprën penale, edhe pse qëllimi dhe dashja e të pandehurve është vërtetuar nga provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, në veçanti opinionin ligjor të Departamentit Ligjor të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR), si dhe raportin e ekspertit financiar, i cili ka përcaktuar se vendimi i ministrit KM..., datë 03.04.2018, me numër të protokollit ..., për hartimin e “Programit të Veçantë”, ishte në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, pasi që nuk ishte bërë vlerësim i shpenzimeve për këtë program të veçantë në objektivat dhe aktivitetet e MBPZhR-së në kornizën afatmesme 2018-2020, e poashtu, programi në fjalë nuk ka qenë i buxhetuar për vitin 2018.

## 6. Vlerësimet e Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikoi shkresat e lëndës dhe analizoi pretendimet e paraqitura në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe as me ndonjë shkelje tjetër të procedurës penale, të cilat do të mund të ndikonin mandej në ligjshmërinë dhe drejtshmërinë e këtij vendimi gjyqësor, siç nuk është shkelur as ligji penal në favor të të pandehurve: N. R. dhe K. H.

Gjykata e shkallës së dytë në arsyetimin e aktgjykimit të saj ka paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta, në lidhje me atë se pse ka vendosur që t’i lirojë nga akuza të

pandehurit: N. R. dhe K. H., referuar nenit 369, paragrafi 10 lidhur me nenin 363, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të KPP-së.

Arsyet e tilla të gjykatës së shkallës së dytë, jo vetëm që janë të qarta dhe të mjaftueshme, por të njëjtat si të tilla gjejnë mbështetje edhe materialin provues, si dhe në përmbajtjen e vetë dispozitës ligjore me të cilën është parashikuar vepra penale për të cilën të pandehurit në fjalë janë akuzuar dhe shpallur fajtor.

Arsyetimet e gjykatës së shkallës së dytë, marrë në tërësinë e tyre, përbëjnë një vlerësim të tërësishëm të të gjitha aspekteve të rëndësishme në lidhje me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me veprën penale dhe përgjegjësinë penale të të pandehurve: N. R. dhe K. H., andaj edhe si i tilla, mund të konstatohet se arsyetimet e tilla janë hartuar dhe paraqitur, konform dispozitës ligjore të nenit 404, paragrafi 1 të KPP-së, kështu që në këtë drejtim, pretendimet e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit janë të pabazuara.

Përndryshe, duke u bazuar në nenin neni 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPP-së, gjykata duhet që në aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e shpall fajtor shënon: “veprën penale për të cilën shpallet fajtor, së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal”, kurse duke u bazuar në nenin 369, paragrafi 7 të KPP-së, duhet që “Gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata gjithashtu, në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij”.

Në këtë drejtim, të pandehurit: N. R. dhe K. H., nga gjykata e shkallës së parë janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, nga neni 422, paragrafët 1 dhe 2, nën-paragrafët 2.1. dhe 2.2. lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Me këtë rast, Gjykata Supreme e Kosovës e sheh të nevojshme që t’i elaborojë elementet e veprës penale “Keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar”, nga neni 422 të KPRK-së, për të cilën të pandehurit në fjalë ishin akuzuar dhe shpallur fajtor nga gjykata e shkallës së parë.

Në nenin 422, paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se veprën penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar e kryen “Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t’i shkel të drejtat e personit tjetër...”.

Nga ky përkufizim ligjor, sipas nenit 422, paragrafi 1 të KPRK-së, rezulton se kjo vepër penale përbëhet prej këtyre elementeve :

- 1) Kryes i kësaj vepre penale mund të jetë personi zyrtar (domethënia e shprehjes “person zyrtar”, përveç tjerash është paraqitur edhe në nenin 120, paragrafi 2 të KPRK-së);
- 2) Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar;
- 3) Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë: në tejkalimin e kompetencave ose mos përmbushjen e detyrave zyrtare dhe
- 4) Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me qëllimin e kryesit që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t’i shkel të drejtat e personit tjetër.

Elementet e lartcekura prej 1) deri 3) i përbëjnë elementet objektive të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar (ndryshe të ashtuquajtura “Actus Reus”), kurse elementi sipas pikës 4) përbën elementin subjektiv të veprës penale të lartcekur (ndryshe e ashtuquajtura “Mens Rea”). Për tu konsideruar se është kryer vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, nga neni 422 të KPRK-së, duhet që të përmbushen në mënyrë kumulative të gjitha këto elemente të lartcekura, ndërsa tek elementet 2) dhe 3), mjafton që të manifestohet së paku njëri prej elementeve të përcaktuar në mënyrë alternative.

Në rastin konkret, nga shkresat e lëndës shihet se gjykata e shkallës së parë kishte konstatuar se veprimet e të pandehurve që janë të përshkruara si veprime kryerëse, i përbëjnë elementet subjektive dhe objektive të veprës penale në fjalë, të theksuar më lart. Mirëpo, gjykata e shkallës së dytë nuk i ka akceptuar qëndrimet e gjykatës së shkallës së parë se në rastin konkret është arritur që të vërtetohet aspekti subjektiv i veprës penale, përkatësisht që të pandehurit: N. R. dhe K. H. të kenë ndërmarrë veprimet përkatëse (elementet objektive) me dashje dhe me qëllim të përfitimit për kompanitë: Konzorciumi “N.” sh.p.k., Konzorciumi “Dh.”, sh.p.k., Konzorciumi “D. Z. P.” dhe Konzorciumit NTP “A. E.” në P.”, (elementi subjektiv).

Me qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë se në rastin konkret nuk është arritur që të vërtetohet përtej dyshimit të bazuar mirë se të pandehurit të ketë vepruar me dashje dhe me qëllimin e lartcekur, pajtohet edhe Gjykata Supreme e Kosovës. Kjo për faktin se për shkak të vetë rrethanave të rastit konkret dhe referuar edhe materialisht provues, nuk është arritur që të vërtetohet përtej çdo dyshimi të bazuar se dashja dhe qëllimi i lartcekur, e të cilat përndryshe konsiderohen elemente subjektive të veprës penale për të cilën ishin akuzuar sipas aktakuzës së PRSK-së dhe ishin shpallur fajtor nga ana e gjykatës së shkallës së parë të pandehurit: N. R. dhe K. H.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur që në mënyrë të qartë dhe të mjaftueshme, në aktgjykimin e saj të arsyeton aspektet subjektive, si elemente të figurës së veprës penale për të cilën të pandehurit në fjalë, i kishte shpallur fajtor, edhe pse e ka pasur për detyrë që ta bëjë një gjë të tillë, bazuar në dispozitat ligjore të nenit 369, paragrafi 7 të KPRK-së.

Në rastet e tilla, kur “qëllimi” i caktuar është element subjektiv i veprës penale përkatëse, atëherë gjykatat duhet që në arsyetimin e aktgjytimeve të tyre, të paraqesin arsye të qarta dhe të mjaftueshme, përveç sa i përket aspekteve tjera objektive, edhe sa i përket qëllimit të tillë, si element subjektiv i veprës penale, ndërsa në rastin konkret, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ka arritur që ta përmbush një standard të tillë.

Gjykata e shkallës së parë nuk kishte arritur që të arsyetojë ekzistimin e ndërlidhjes në mes veprimeve kryerëse të pandehurve: N. R. dhe K. H., që kanë të bëjnë me hartimin e programit të veçantë në bujqësi në kundërshtim me ligjet përkatëse dhe qëllimit të tyre që t’ju mundësojnë përfitim të kundërligjshëm kompanive të lartcekura, duke i shkaktuar dëm buxhetit të Republikës së Kosovës në shumë prej 3.356,085.77 euro. Pra, nuk është arritur që të arsyetohet mjaftueshëm, se të pandehurit në fjalë kanë qenë të motivuar dhe kanë pasur për qëllim që me veprimet e tyre, që ndërlidhen me programin e veçantë të bujqësisë t’i kenë ndërmarrë me qëllim që kompanitë e lartcekura të përfitojnë në mënyrë të kundërligjshme.

Siç me të drejt ka konstatuar edhe gjykata e shkallës së dytë, në rrethanat e rastit konkret, nuk është e mjaftueshme vetëm lidhja objektive në mes të hartimit të programit të veçantë të bujqësisë, shkeljes së dispozitave ligjore dhe përfitimit të kompanive, të cilat kanë qenë përfituese të granateve, por që në mes këtyre veprimeve duhet të ekziston edhe lidhshmëria subjektive “komponentja subjektive tek të pandehurit”, se të njëjtit i kanë ndërmarrë këto veprime për të krijuar përfitime të paligjshme kompanitë e lartcekura, andaj edhe nga aspekti ligjor kërkohet që të argumentohet, në mënyrën që të vërtetohet se a ekzistonin lidhjet e tilla, raportet e të pandehurve me kompanitë e lartcekura dhe cilat janë faktet dhe provat që e argumentojnë një gjë të tillë.

Sa i përket veprimeve të të pandehurit N. R., në cilësinë e ministrit të MBPZhR-së të Republikës së Kosovës, më 26.03.2018, kishte nxjerrë vendimin nr.Ref..., për hartimin e politikave të reja për zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës rurale dhe ngritjen e konkurrencëshmërisë në zonat më pak të zhvilluara, me ç’rast pas vendimit, draftin për përgatitjen e programit ua kishte dorëzuar komisionit - grupit punës, gjykata e shkallës së parë nuk kishte arritur që të arsyetojë, nëse ky vendim i të pandehurit, kishte pasur qëllim në kuptimin e elementeve subjektive të figurës së veprës penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor, ndërsa nuk kishte për qëllim zhvillimin e infrastrukturës rurale dhe ngritjes së konkurrencëshmërisë në zonat rurale më pak të zhvilluara. Siç nuk janë arsyetuar mjaftueshëm, as aspektet që do të argumentonin dijeninë e të pandehurit N. R., që më rastin e hartimit të programit në fjalë, mandej në konkursin dhe procedurat e përcaktuara për



fitimin e granateve do të aplikojnë kompanitë: K. “N.” sh.p.k., Konzorciumi “Dh.”, sh.p.k., Konzorciumi “D., Z. P.” dhe Konzorciumit NTP “A. E.” në P.”.

Gjithashtu, në mënyrë të njejtë, nuk është arritur që të arsyetohet nëse veprimet kryerëse të të pandehurit K. H., i cili në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të MBPZhR-së, kishte marrë vendimin nr.1257, për formimin e grupit punës në përbërje prej njëmbëdhjetë (11) anëtarëve, i cili grup kishte për detyrë përgatitjen e investimeve në infrastrukturën rurale në Kosovë, ishin ndërmarrë me qëllimet e lartcekura.

Përtej këtij aspekti subjektiv, gjykata e shkallës së dytë ka arsyetuar se veprimet e të pandehurit K. H., që ndërlidhen me formimin e grupit punës, në vetvete nuk përbëjnë shkelje ligjore, përkatësisht shkelje të Ligjit për Administratë Shtetërore, pasi që në nenin 38, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.2. të këtij Ligji, është përcaktuar se “Sekretari i përgjithshëm ka përgjegjësitë kryesore që të siguron që vendimet e politikave dhe masat tjera të ministrisë të zbatohen në mënyrë efikase dhe efektive”.

Mbi bazën e të gjitha provave që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë, por as nga rrethanat faktike të rastit, gjykata e shkallës së dytë kishte arritur në përfundimin se nuk është arritur që të argumentohet se të pandehurit: N.R. dhe K. H., t’i kenë ndërmarrë veprimet kryerëse, që ndërlidhen me programin e veçantë për bujqësi dhe me formimin e grupit punës prej njëmbëdhjetë (11) anëtarëve, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të kompanive të lartcekura. Përndryshe, shkeljet tjera të natyrës administrative dhe menaxheriale, vetëm si të tilla, janë të pamjaftueshme për të ardhur deri tek përfundimi se të pandehurit në fjalë kanë kryer veprën penale për të cilën ishin akuzuar, në mungesë edhe të aspekteve tjera subjektive.

Duke u bazuar në të gjitha këto që u theksuan më lart, arsyetimet e gjykatës së shkallës së dytë në drejtim të përgjegjësisë penale të të pandehurve: N. R. dhe K. H. janë të drejta dhe gjejnë mbështetje në shkresat e lëndës, si dhe në dispozitat përkatëse ligjore të paraqitura më lart, andaj edhe si të tilla janë të pranueshme edhe për Gjykatën Supreme të Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës e konsideron të pabazuar edhe pretendimin e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit që ndërlidhet me vlerësimin në mënyrë të veçantë të provave kundërthënëse dhe pretendimin në lidhje me zbatimin e nenit 392 të KPP-së që i referohet mbajtjes së shqyrtimit pranë gjykatës së shkallës së dytë, me qëllim që të merren prova të reja, pasi që shqyrtimi pranë kësaj gjykate mbahet vetëm në rastet kur vlerësohet se është e nevojshme që për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, të merren prova të reja ose të përsëriten provat e marra më parë dhe kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme që lënda të mos i kthehet gjykatës themelore në rigjykim. Pra, mbajtja e shqyrtimit rezulton se nuk është detyrim për gjykatën e shkallës së dytë, por që kjo vlerësohet nga rrethanat specifike të secilit rast veç e veç dhe është nën përgjegjësinë e gjykatës së shkallës së dytë, që të vendos nëse duhet mbajtur një shqyrtim i tillë, apo vendosja në lidhje me ankesat kundër aktgjyqimit të bëhet gjatë seancës së kolegjit. Kështu, që gjitha provat e administruar janë vlerësuar dhe analizuar nga gjykata e shkallës së parë,

ndërsa përfundimet e saj, gjykata e shkallës së dytë i ka nxjerrë duke u bazuar në tërë materialin provues dhe provat të cilat i kishte administruar gjykata e shkallës së parë, e që një mundësi e tillë gjen mbështetje edhe në dispozitat ligjore të KPP-së.

Gjykata Supreme e Kosovës e konsideron të pabazuar edhe pretendimin e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit që ndërlidhet faktin se gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare nuk ka bërë përpjekje për sigurimin e provave të reja, në mënyrë që të dëshmojë lidhjen objektive në mes të hartimit të programit të veçantë të bujqësisë, shkeljeve të dispozitave ligjore dhe përfutimit të kompanive të cilat kanë qenë përfituese të granteve, në njërën anë, me lidhjen subjektive të të pandehurve, që këto veprime i kanë ndërmarrë për të krijuar përfitime të paligjshme për kompanitë e lartcekura. Kjo për faktin se bazuar në nenin 346, paragrafi 1 të KPP-së, sigurimi i provave shtesë, sipas detyrës zyrtare nga ana e gjykatës, është vetëm një mundësi fakulative, por nuk është detyrim, ndërsa një mundësi e tillë fakulative vjen në shprehje vetëm në rastet kur konsiderohet e “domosdoshme” për përcaktimin e së vërtetës. Përkundrazi, Gjykata Supreme e Kosovës thekson se në çështje penale të natyrës së tillë, është detyrim në rradhë të parë, i prokurorit të shtetit që të ofron prova për të vërtetuar aspekte të rëndësishme që ndërlidhen me veprën penale përkatëse dhe përgjegjësinë penale të të pandehurve. Pra, barra e të provuarit, kryesisht dhe në parim, bie mbi prokurorin e shtetit dhe një detyrim i tillë derivon nga vetë natyra e parimit të prezumimit të pafajësisë, që është i parashikuar dhe garantuar, jo vetëm me dispozitat ligjore vendore (dispozitat ligjore dhe kushtetuese), por edhe me dokumente të rëndësishme ndërkombëtare dhe është promovuar vazhdimisht edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (çështja “Capeau kundër kundër Belgjikës”, nr.42914/98, aktgjykimi i datës 13.01.2005, paragrafi 25; çështja “Barberà, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës”, nr.10590/83, aktgjykimi i datës 06.12.1988, paragrafi 77, etj.).

Gjithashtu, edhe në Direktivën nr.343/2016 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 09.03.2016, për fuqizimin e aspekteve të caktuara të prezumimit të pafajësisë dhe të drejtës për të qenë prezent në gjykim në procedurë penale, në pikën 22, është parashikuar se “Barra e provës për vërtetimin e fajësisë së të dyshuarve dhe të akuzuarve është e prokurorisë dhe çdo dyshim duhet të jetë në dobi të të dyshuarit apo të akuzuarit”.

Pra, bazuar në këto që u theksuan më lart, rezulton qartë se gjykata ka të drejtë (neni 325, paragrafi 4 i KPP-së) dhe mundësi (neni 346, paragrafi 1 i KPP-së) që gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, në këtë rast, duke u bazuar edhe në nenin 392 të KPP-së, “ex officio” të urdhëron shqyrtimin e provave të caktuara, nëse një gjë e tillë është e “domosdoshme” për përcaktimin e së vërtetës, mirëpo tek rastet e veprave penale të tilla, për të cilat janë akuzuar të pandehurit: N. R., K. H., në rradhë të parë, barra e propozimit dhe sigurimit të provave që ndërlidhen me veprën penale përkatëse dhe përgjegjësinë penale eventuale të të pandehurve, bie mbi prokurorin e shtetit.

Në fund, si rezultat i të gjitha këtyre që u paraqiten më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur deri tek konkludimi se përmes aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë rezulton se gjykata në fjalë ka përmbushur edhe detyrimet e saj për të paraqitur arsye edhe sa i

përket çështjeve tjera, referuar nenit 369, paragrafit 7 të KPP-së. Në këtë kontekst, nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë shihet që janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe në mënyrë të plotë arsye mbi bazën e të cilave, gjykata në fjalë ka konstatuar se në këtë rast nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të pandehurit: N. R. dhe K. H., t'i kenë kryer veprat penale për të cilat ish-in akuzuar, ashtu siç është parashikuar në nenin 369, paragrafi 10 të KPP-së.

Pas të gjitha këtyre që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë nuk është shkelur as ligji penal në favor të të pandehurve: N. R. dhe K. H., pasi që lidhur me veprën penale ka zbatuar dispozitat ligjore që është dashur të zbatohen. Kjo për faktin se gjykata në fjalë ka paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të plotë se në rastin konkret nuk është arritur që të vërtetohet përtej dyshimit të bazuar mirë se në veprimet e të pandehurve: N. R. dhe K. H., ka ekzistuar dashja (dashja e drejtpërdrejtë) dhe qëllimi përkatës, si komponentë subjektive të veprës penale për të cilën të njëjtin ish-in akuzuar nga PSRK dhe shpallur fajtor nga gjykata e shkallës së parë.

Në fund, Gjykata Supreme e Kosovës, edhe në këtë çështje penale, rithekson se “jo çdo shkelje e detyrës zyrtare mund që të kualifikohet edhe si vepër penale e keqpërdorimit të detyrës zyrtare apo autoritetit, por që krahas kësaj, duhet që të vërtetohet përtej dyshimit të bazuar mirë, edhe ekzistimi i elementeve përkatëse subjektive, ashtu siç parashihet me dispozitat ligjore që e parashikojnë këtë vepër penale”.

Në këtë mënyrë, nga arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar dhe pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.495/2024, më 17.01.2025

Procesmbajtës,  
Sherif Krasniqi

Kryetar i kolegjit,  
Rasim Rasimi